



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3286_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2971_06_26** i datës 08.06.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 19.06.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **A. D.**, nga Komuna e Fushë Kosovës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2971_06_26 i datës 08.06.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 08.06.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2971_06_26 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit A. D., me shifër DPR - 90097812, lidhur me kontestimin e taksës së shqyçjes.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Cila është baza ligjore e aplikimit të taksës së shqyçjes;
- Si dhe kërkon aprovimin e ankesës si të bazuar, ashtu që të shfuqizohet vendimi i kontestuar dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 19.06.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 08.06.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 10.10.2025, Përgjigjen e KESCO-s, Procesverbalin e shqyçjes, Transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit dhe



Rrjedhën e energjisë elektrike si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Nga analizimi i përgjithshëm i Transaksioneve, Listave të Leximit dhe Rrjedhës së Energjisë Elektrike për konsumatorin me shifër DPR – 90097812, Bordi konstaton se, ky konsumator është lexuar dhe është faturuar bazuar në shpenzimet reale mujore. Më tej, është vënë re që, është lexuar dhe faturuar me rregull, dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse. Nga analizimi i mëtejshëm i Transaksioneve të konsumatorit si dhe procesverbalit të shqyçjes nr. 5506552 të datës 15.07.2025 vihet re që, konsumatori është shqyçur me dt. 15.07.2025, për shkak të borxhit në vlerë prej **52.65 €**.

Në pretendimin e konsumatorit që nuk është paralajmëruar për shqyçje, Bordi thekson se, shkalla e parë në ZRrE, DMK me të drejtë ka konstatuar se një pretendim i tillë nuk qëndron, sepse, konsumatorët me rastin e pranimit të faturave e kanë afatin ligjor të përcaktuar për pagesë të tyre. Një zgjidhje e tillë, parashihet në nenin 29 – Pagesa e faturave, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si në vijim: “Periudha prej dorëzimit të faturave të konsumatorët deri te afati i pagesës së borxhit për të gjitha pagesat aktuale nuk duhet të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë”. Ndërkaq, Njoftimi paralajmërues, u bashkëngjitet konsumatorëve në çdo faturë, me vërejtjen si në vijim: “Pagesa me kohë e faturës së energjisë elektrike është obligim ligjor. Nëse nuk i përmbushni obligimet e juaja në afat prej 15 ditëve, pas datës së skadimit të afatit për pagesë, furnizimi me energji elektrike do të shqyçet për mos pagesë”. Ndërkaq, në Njoftimin për Shqyçje, i cili bashkëngjitet në faturë, konsumatorët njoftohen si në vijim: “Paguani deri me dt. X. Përndryshe jemi të detyruar të iu shqyçim nga rrjeti elektrik pa ndonjë vërejtje të mëtejme”.

Sa i përket çështjes së ngritur nga konsumatori, rreth bazës ligjore të aplikimit të taksës së shqyçjes, e njëjta është e përcaktuar në Rregullën për Shqyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve, si pjesë përbërëse e rregullës në fjalë, e aprovuar në muajin 03/2027.

Bordi thekson se, KESCO ka vepruar në harmoni me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht me nenin 5 – Shqyçja për mos pagesë të energjisë, të Rregullës për Shqyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në sektorin e energjisë si vijon: “Ndërmarrja e energjisë mund ta shqyçë konsumatorin i cili nuk i përmbahet afatit të pagesës, sipas dispozitave të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, neni 14 par. 1 dhe neni 15 par. 1 ose në kontratën për furnizim”.

Rrjedhimisht, konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të cilën e shfrytëzojnë dhe kjo duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me energji elektrike, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: “Konsumatorët e kanë për obligim që paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”.



Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuara nga KESCO si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si dhe Rregullën për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve nw Sektorin e Energjisë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **A. D.**,
- Arkivit të ZRrE-së